



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14322 Prot.

Lezhë, më 30 . 07 . 2021

VENDIM

Nr. 119 , Datë 29 . 07 . 2021

PËR

“SHPLLJEN E ZGJEDHJEVE PËR KRYESITË DHE KRYETARËT E FSHATRAVE”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;neni 8, neni 53, neni 54 dhe pikes 4 të nenit 70, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.11.,datë 26.08.2020 “Për miratimin e lagjeve në fshatra, zgjedhjen e anëtareve të kryesisë dhe të kryetareve të fshatrave në Bashkinë Lezhë”, të ndryshuar, Relacionin e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

- Shpalljen e zgjedhjeve për Kryesitë dhe Kryetarët e Fshatrave, në fshatrat si më poshtë:
  - Fshati Grykë Lumi, në Njësinë Administrative Shenkoll
  - Fshati Kallmet i Vogel, Njësia Administrative Kallmet
  - Fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej
  - Fshati Mali i Rrencit, Njësia Administrative Shengjin
  - Fshati Baqel, Njësia Administrative Blinisht
  - Fshati Gramsh, Njësia Administrative Dajç
- Procesi i zgjedhjeve për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të zhvillohet në periudhen **30.07.2021 deri me 30.09.2021**.
- Zhvillimi i mbledhjes të ndiqet nga anëtarët e Këshillit të Bashkisë Lezhë për çdo njësi administrative sipas ndarjes së mëposhtme:
  - Blinisht** (Redi Brunga, Markiljan Lushaj, Artan Ndreu, Aurela Prendi, Aleksander Kolvataj )
  - Dajç** (Emirjan Lazri, Elsa Gazulli, Argjontjano Noka, Erin Gjoni, Donika Ndreu)
  - Kallmet** (Marte Simoni, Visar Alia, Markiljan Lushaj,Marko Jaku, Jorida Mikaj)
  - Shenkoll** (Ernest Rakaj, Artan Ndreu, Marko Jaku, Alban Bruka, Evarest Ivanaj)
  - Shengjin** (Ardian Marku “Nikulaj”, Brahim Demi, Rigels Nicaj, Regjina Sokolaj, Edlir Reçi)
  - Ungrej** (Gjin Kola, Argjontjano Noka, Ndue Luli, Kristjan Leka, Klejvi Hoxhiqi)
- Dokumentacioni që do të mbahet në zgjedhjen e Kryesive dhe Kryetarëve të Fshatrave, i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Grupi i këshilltareve i ngarkuar për ndjekjen e mbledhjes për organizimin e procesit zgjedhor përcakton datën e zhvillimit të zgjedhjeve brenda periudhes së caktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe vënë në dijeni Kryesinë e Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe Administratorin e Njësive Administrative për datën, orën e zhvillimit të zgjedhjeve.
6. Administratoret e Njësive Administrative marrin të gjitha masat organizative për njoftimin e banoreve mbi 18 vjeç në fshatrat ku do të zhvillohen zgjedhjet.
7. Kryesia e Këshillit, mbi bazën e materialeve të depozituara nga grupi i ngarkuar për ndjekjen e zgjedhjeve për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave përgatit materialin përmbledhes për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Bashkisë.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Grupet e Këshilltareve të caktuar për zhvillimin e zgjedhjeve, Kryesia e Këshillit të Bashkisë dhe Administratoret e Njësive Administrative, Shenkoll, Dajç, Ungrej, Shengjin, Blinisht dhe Kallmet.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI  
ERNEST RAKAJ

